Institucioni	Teatri "Migjeni"	116,516
Institucioni	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	203,525
Institucioni	Drejtoria MZSH	398,835
Institucioni	Drejtoria e Sherbimit Pyjor	83,581
Institucioni	Institucioni Shtepia e Foshnjes	75,220
Institucioni	Institucioni Shtepia e Femijes shkollor	100,892
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	210,783
		5,363,432

Ne llogarine 4341 Te tjera operatione me shtetin (Kreditor) me nje saldo kreditore perj 876,213 leke perfshihen :

Drejtoria Ekonomike e Arsimit	876,213
	876,213

Ne llogarine 435 "Sigurime shoqerore" shuma prej 17,446,745 leke

	Bashkia Administrata + Njesite Administrative	7.637,936
Institucioni	Dega Ekonomike e Kultures	564,551
Institucioni	Drejtoria e Kopshte Çerdheve	3.625,775
Institucioni	Teatri Migjeni	563,234
Institucioni	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	2,708,755
Institucioni	Drejtoria MZSH	780,104
Institucioni	Drejtoria e Sherbimit Pyjor	471,386
Institucioni	Institucioni Shtepia e Foshnjes	270,902
Institucioni	Institucioni Shtepia e Femijes shkollor	386,634
Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	437,468

17,446,745

Ne llogarine 436 "Sigurime shendetesore" shuma prej 2,409,364 lek

	Bashkia Administrata + Njesite Administrative	1,059,231
Institucioni	Dega Ekonomike e Kultures	78,344
Institucioni	Drejtoria e Kopshte Çerdheve	503,162
Institucioni	Teatri "Migjeni"	78,165
Institucioni	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	375,911
Institucioni	Drejtoria MZSH	108,262
Institucioni	Drejtoria e Sherbimit Pyjor	65,420
Institucioni	Institucioni Shtepia e Foshnjes	37,584
Institucioni	Institucioni Shtepia e Femijes shkollor	53,657

Institucioni	Institucioni Qendra e Zhvillimit	49,628
--------------	----------------------------------	--------

Ne llogarine 437 "organizma te tjera shoqerore" shuma prej 7,600 leke

Institucioni	Drejtoria e Kopshte Çerdheve Borxhe kuotizacion sindikatat	7,600
--------------	--	-------

		7,600
--	--	--------------

Ne llogarine 467 "Kreditore te Ndryshem "me nje saldo kreditore prej 68,066,811 leke perfshihen :

Kreditore te ndryshem Bashkia	65,830,578
-------------------------------	------------

Drejtoria Ekonomike e Arsimit	0
-------------------------------	---

Dega Ekonomike e Kultures	1.782.000
---------------------------	-----------

Teatri " Migjeni	265,435
------------------	---------

Drejtoria Kopshte Çerdhe	0
--------------------------	---

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	0
---	---

Drejtori e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore.	0
---	---

Shtepia e Foshnjes	74,907
--------------------	--------

Shtepia e Femijes Shkollor	29,752
----------------------------	--------

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	84,139
---	--------

68,066,811

Ne llogarine 466 "Kreditore per mjete ne ruajtje" me nje saldo kreditore prej 92,579,108 leke perfshihen :

Bashkia + NJA	84,227,298
---------------	------------

Drejtoria Ekonomike e Arsimit	7,140,850
-------------------------------	-----------

Dega Ekonomike e Kultures	686,077
---------------------------	---------

Teatri "Migjeni"	62,481
------------------	--------

Drejtoria Kopshte Çerdhe	372,401
--------------------------	---------

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	0
---	---

Drejtori e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore.	90,001
---	--------

92,579,108

Ne llogarine 470 Llogari ne pritje - Te ardhura per tu marre 1,587,568,660 leke perfshihen :

Te ardhura te regjistruara ne llogarine debitore te ndryshem Bashkia	1.585.365.819
--	---------------

Drejtoria Kopshte Çerdhe	1.802.841
--------------------------	-----------

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi	400.000
---	---------

1,587,568,660

Ne llogarime 26 Pjesmarrje ne kapitalin e vet me vlerë 1,122,968,364 perfshihen :

Shoqëritë	Pjesmarrja e Aksioneve	Vlera e kapitalit bashkise Shkodër
Trajtimi i Studentëve Shkodër	100% të aksioneve	125,563,924
Tregu i Shitjes me Shumice Fruta – Perime	100 % të aksioneve	95,839,440
Ujësjiellës Shkoder Kanalizime	100 % aksione	863,468,000
Parku i Udhëtarëve Shkodër	60 % të aksioneve	13,944,000
Shoqeria Rajonale e Ujësjiellës –Kanalizime Shkoder	36% e aksioneve	14,053,000
Ndermarrja STRAJCA	“BIO 100 % aksione	10,000,000

II. NXJERRJA JASHTË PËRDORIMI TË AKTIVEVE .

Per vitin 2023 eshte kryer procedura e nxjerrjes së perdorimit të aktiveve nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit:

1. Nxjerrje jashtë përdorimi i inventarit te imet dhe inventarit ekonomik ne konviktet , shkollat qytet dhe shkollat e njesive administrative

-Nxjerrje jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit ekonomik ne konvikte, shkollat e qytetit dhe njesive administrative me vlere 5,902,161 leke dhe me vlerë të akumuluar të amortizimit 800.933 leke dhe inventarit te imet me vlere 5,176,343

Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi është bërë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Nxjerrja jashtë përdorimi dhe asgjësimi është bërë duke zbatuar në menyrë rigoroze të gjitha hapat që përcaktohen në Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik”, i ndryshuar..

Vlerësimi i aktiveve është bërë duke pasur parasysh kriteret e vlerësimit të aktiveve si :

plotësimi i kohës së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit

pamundësinë e riparimit si pasojë e konsumit

dëmtimi në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit

kur vlera e riparimit ose e pershtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm

kur kanë humbur cilësinë e tyre të caktuara në standartet shtetërore ose në kushtet teknike

Grupi i inventarizimit i ngritur me urdherin nr 86 date 19.10.2023 ka bërë inventarizimin e aktiveve duke krahasuar gjendjen fizike me atë kontabel .grupi ka dhënë gjykimin e tij për gjendjen e tyre duke vënë tek kolona shënime për ato materiale që i kanë gjykuar jashtë funksioni

Duke pasë parasysh kriteret e vlerësimit të inventareve grupi i vlerësimit të aktiveve të vlerësuar si jashtë funksioni i ka paraqitur Drejtorit të Drejtorisë Arsimit relacionin përkatës të aktiveve të identifikuar për vlerësim të cilat rezultuan jashtë funksionit dhe janë dërguar në magazinë pranë konviktit të shkollës Industriale si mall në ruajtje deri në vlerësimin përfundimtar nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi ose i tjetërsimit të tyre. Pas marrjes së relacioneve Drejtori ngriti grupin e nxjerrjes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve me urdherin Nr.106 date 18.12.2023 i cili pasi verifikoi në sasi dhe në vlerë aktivet që ishin pasqyruar në procesverbalin dhe relacionin e vlerësimit duke kontrolluar gjendjen e tyre fizike dhe bërë analizen kosto përfitim vendosi që këto materiale nuk mund të përdoren për qëllime të tjera dhe dha mendimin që duhet që të asgjësohen.

Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit paraqiti proces-verbalin përkatës tek Drejtori.

Drejtori miratoi asgjësimin e materialeve me Vendimin nr. 1 datë 03.01.2024 për konviktet,shkollat e qytetit dhe NJ.A “ Për miratimin e asgjësimit të materialeve të ndryshme të konsumuara të cilat nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera “.

Komisioni i asgjësimit i ngritur me Urdherin Nr.2 dt.09.01.2024 pas marrjes së miratimit të Drejtorit për asgjësimin e materialeve të inventarit mundësoi më parë shkatërrimin e tyre me

mjete të përshtatshme për ti bërë ato krejtësisht të gatshme për t'u asgjesuar i cili u krye në vend grumbullimine mbeturineve të qytetit .

III. DETAJIMI I DETYRIMEVE TË PALIKUIDUARA NË FUND TË VITIT BUXHETOR 2023

Në fund të vitit 2023 kemi një gjendje detyrimesh në shumën prej 166,677,981 lekë shumë e cila përbëhet nga :

Llogaria	Emertmi	Bashkia + Institucionet
40	Furnitore e llogari te lidhura me to	12,262,008
42	Personeli e llogari te lidhura me to	60,246,008
431	Shteti tatim-taksa	5,363,432
435	Sigurime shoqerore	17,446,745
436	Sigurime shendetore	2,409,364
437	Organizma te tjere shteterore	7,400
467	Kreditore te ndryshem	68,066,811
44	Institucione te tjera publike	0
4341	Operacione me shtetin(detyrime)	876,213
	Totali	166,677,981

Ju, sqarojmë se sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 35, datë 29.12.2023. "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme", detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 40, germa “h”, detyrimet e Bashkisë Shkodër janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave nga ish Komunat (Njësitë Administrative). kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”, si dhe parashikimit optimist të të ardhurave.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder”, Bashkia Shkoder, ka trasheguar nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata.

Për vitin 2023, Bashkia Shkoder, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresat si më poshtë:

- Shkresë nr 7239 prot, datë 24.05.2023 me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Prill 2023 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër”.
- Shkresë nr 12786 prot, datë 13.09.2023 me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Gusht 2023 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër”.
- Shkresë nr 3406 prot, datë 16.02.2024 me objekt ‘Dorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodër”.

Bashkia Shkodër ka vetëm një vlerë prej 571.032 lekë stok të regjistruar në sistemin informatik të qeverisë, e cila është në proces gjyqësor. Raporti i kësaj shume mbi totalin e shpenzimeve rezulton të jetë 0.03%.

Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, janë katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Bashkia Shkodër është bashki që nuk ka detyrime, e ka nivelin e stokut te papërfillshëm dhe është në gjendje shumë të mirë financiare.

Në ligjin nr 68/2017, përcaktohet se “Rastet sipas gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”(Aneksi 1) dhe “Treguesit fiskale te konsoliduar te NJVQV” (Aneksi 2), jane dy tabelat që do raportohen **një herë në katër muaj në Ministrinë e Financave, së bashku me raportin e monitorimit.**

Bashkia Shkoder

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes fiannciar e	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%

Sqarojmë se bashkia Shkodër ka likuiditete, fonde disponibël, por përsa kohë që procedurat janë me mungesë dokumentacioni, si dhe procese gjyqësore të cilat janë në proces, këto procedura nuk mund të rregjistrohen si detyrime të prapambetura, por të gjitha këto detyrime janë të pasqyruara në bilanc.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

IV.1. AUDITI I BRENDSHËM

Veprimtaria e Njesisë Auditimit Brendshëm është bazuar në 114/2015 “Per Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, ligji nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar V.K.M Nr. 83, date 03.02.2019 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, Urdhërin e Ministrit të financave nr. 100 datë 25.10.2019 “Për miratimin e manualit auditimit brendshëm në sektorin publik, Udhëzimin e minisatrisë Financave nr. 42 datë 27.10.2020” Mbi ndjekjen e zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në Sektorin publik”.

IV.1.1 . Organizimi i Njesisë Auditimit- Bashkia Shkodër.

Analiza e programeve të AB për periudhën raportuese: Për vitin 2023, janë planifikuar për auditim 10 subjekte, nga të cilat katër subjekte për auditim përputhshmërie, një auditim financiar si dhe pesë subjekte për auditime kombinuara.

Gjatë vitit 2023, janë kryer 9 misione auditimi nga të cilët 8 misione auditimit janë përfunduar, një mision auditimit është në fazën e përfundimit të raportit final.

Plani vjetor për vitin 2023 ka patur dy ndryshme, ku me kërkesë të kryetar i bashkisë, është bërë rishikim i planit vjetor, duke bërë zëvendësim i misioneve të auditimit. Për subjektet që kanë qënë të planifikuara për vitin 2023, por nuk janë audituar për arsye të kërkesës për ndryshim, janë planifikuar të kryhen gjatë vitit 2024.

Analiza e misioneve të AB: Për të gjitha misionet e auditimit të kryera gjatë vitit 2023, janë ndjekur procedurat standarte të përcaktuara nga manuali i auditimit, përfshirë njoftimin paraprak (10 ditë para fillimit misionit auditimit), përpilimi i autorizimit, marrja e informacionit paraprak të organizatës, takimi me drejtuesit e organizatës dhe rënia dakort për realizimin e auditimit, përpilimi i projekt e programit auditimit, ndarja e detyrave të auditeve, përpilimi i projektit dhe raportit final të auditimit, takimi pajtues me drejtuesit e njësisë audituar, përpilimi i memorandumit, ku në menyrë të përmbledhur është informuar Kryetari i Bashkisë.

Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre: Njësia e Auditimit që në fazën e planifikimit ka bërë evidentimin dhe vlerësimin e riskut, bazuar në objektivat e auditimit, ku gjatë përpilimit të programeve të angazhimit fushave të vlerësuara me risk të lartë e të mesëm i është dhënë përparsi.

Për vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga ana jonë është përpiluar një pyetësor i detajuar me pyetje të cilat përfshijnë veprimtarinë kryesore të subjekteve audituara. Mbi bazën e pyetësorit janë përcaktuar drejtimet e auditimit për monitorimin e menaxhimit financiar.

Rezultatet e auditimit: Nga kryerja e misioneve të auditimit për vitin 2023, janë konstatuar gjetje të cilat janë argumentuar me bazë ligjore si duhej të ishin kryer procedurat e punës, si janë kryer në fakt procedurat, si dhe janë dhënë rekomandimet me afate për përmirësimin e punës.

Per vitin 2023 janë konstatuar shkelje të disipline financiare me dëm ekonomik në vlerë 192.725 mijë lekë, janë konstatuar 115 gjetje, dhe janë dhënë 121 rekomandime për përmirësimin e punës.

Zbatimi i rekomandimeve: Për vitin 2023, bazuar në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e punës në subjektet e audituara janë dhene 121 rekomandime. Nga 121 rekomandime të lëna, janë pranuar 117 rekomandime, ndersa nuk janë pranuar 4 Rekomandime.

Rekomandimet e lëna në vitin 2023 do të auditohen gjatë muajit Mars 2024.

IV.2 AUDITIMI I JASHTËM

- Shkrese nr 1019/11 prot date 20.01.2023 me objekt "Dergim i raportit perfundimtar te Auditimit dhe kerkese per zbatimin e rekomandimeve te lena nga KLSH-ja, ne auditimin e fundit ne bashkine Shkoder, miratuar me Vendimin e kryetarit te KLSH-se nr.18. date 19.01.2023.
- Shkrese kthim pergjigje me nr 311/6 prot date 10.02.2023 me objekt "Mbi zbatimin e masave te ndermarra ne Zbatim te rekomandimeve dhe Raportit perfundimtar te KLSH-se nr 1019/11 prot date 20.01.2023
- Shkrese nr 311/b prot date 25.01.2023 me objekt 'Sqarim i raportit perfundimtar te auditimit nr.1019/11 date 20.01.2023.
- Shkrese nga KLSH me nr.627 prot date 06.07.2023 me objekt "njoftim per fillimin e Projekt Auditimit", hyre me prot bashkia nr 9486 prot date 07.07.2023.
- Shkrese nr 627/5 prot date 07.07.2023 me objekt "program auditimi tematik me objekt "per verifikimin e zbatimit te rekomandimeve te lena ne auditimet e meparshme te evaduara per periudhen 01.07.2022-31.01.2023". hyre me prot bashkia nr 9486/1 prot date 18.07.2023.
- Shkrese nr 655 prot date 17.07.2023 me objekt "Program auditimi tematik me objekt 'Per zbatimin e rekomandimeve te lena ne auditimet e performances te evaduara ne vitin 2022".
- Shkrese nr 627/10 prot date 04.08.2023 me objekt "Dergohet projekt raporti i Auditimit". prot hyres bashkia nr.9486/4. date 08.08.2023
- Shkrese nr 627/19 prot date 10.10.2023 me objekt "Dergohet raporti perfundimtar i Auditimit dhe kerkese per zbatimin e rekomandimeve te lena nga KLSH ne auditimin e fundit ne bashkine Shkoder, percjelle me shkresen nr.373/8 prot date 18.07.2022.
- Shkrese nr.973/2 prot date 13.12.2023 me objekt "Njoftim ndryshimi te programit te Auditimit".

V. MASAT E MARRA GJATË VITIT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË NJËSI DHE PLAN VEPRIMI PËR TË ARDHMEN

Në kuadër të përmirësimeve të vazhdueshme për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit, në përputhje dhe me gjetjet për këtë fushë, janë përmirësuar si më poshtë:

- Zhvillimi i planifikimit strategjik, sidomos në kuadër të koordinimit të planifikimit strategjik dhe atij operacional, lidhjes së objektivave strategjike dhe programeve, si dhe të parashikimit të fondeve të nevojshme financiare për implementimin e tyre.
- Zhvillimin i konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe krijimi i parakushteve me qëllim përcaktimin e autoriteteve dhe përgjegjësive të qarta për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore në mënyrë objektive.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit, veçanërisht në proceset e ciklit të buxhetit, duke përfshirë proceset e planifikimit, programimit, dhe ekzekutimit të planeve financiare, si dhe në procesin e prokurimit dhe kontraktimit, duke theksuar kryesisht zhvillimin e kontrolleve ex-ante (për shembull: kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të ndikimit të projekteve të propozuara mbi fondet publike, apo përcaktimin e kriterëve të qarta për alokimin e fondeve, etj) dhe kontrolleve ex-post (si kontrolle në vend, etj.).
- Kryerja e vetëvlerësimit periodik të sistemit të kontrollit të brendshëm nga ana e nivelit të lartë menaxherial të njësisë publike, për identifikimin e mangësive të mundshme dhe zbatimin e kontrolleve më efektive.
- Realizimi i programeve të trajnimeve gjithëpërfshirëse për punonjësit lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës së institucionit si dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnimin e stafit në lidhje me zbatimin e instrumentave të kontrollit të brendshëm.
- Hartimi dhe miratimi nga ana e njësisë publike të procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.
- Hartimi i planeve operationale të konsoliduara të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Përdorimi i mundësisë së delegimit si një element i rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe realizimin me efektivitet të funksioneve të nivelit të lartë menaxherial.

- Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- Përfshirja në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

VI. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Për të siguruar përmbushjen e objektivave të institucionit të Bashkisë Shkodër për një menaxhim sa më efektiv të burimeve publike dhe pas analizës së bërë në kuadër të kontrollit të brendshëm:

Rekomandojmë :

- Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe kryerjen e vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve nga ana e njësisë publike. në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimit të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të njësisë publike në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e korrupsionit dhe mashtrimit. në rastet e shkeljeve të sinjalizuara.
- Ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.
- Kryerjen e procedurave standarde të veprimit sipas drejtorive, sektorëve, njësive, etj.
- Në kuadër të përmirësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të rritjes së transparencës të përdorimit të fondeve të bashkisë Shkodër, si dhe për një menaxhim sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare, është e nevojshme instalimi i sistemit financiar. Lidhur me sistemet e kontabilitetit, njësia publike duhet të ketë një program të unifikuar si dhe parashikimi për përmirësime të mëtejshme në sistemin e kontabilitetit.
- Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

- Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e proceseve të vendimmarrjes, vendimeve strategjike dhe operacionale, mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut, promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda organizatës, sigurimin e menaxhimit efektiv organizativ të performancës dhe llogaridhënies.
- Angazhimin e audituesve të brendshëm në vlerësimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve për arritjen e objektivave strategjike të njësive publike.
- Monitorimin në vazhdimësi nga njësitë e auditimit të brendshëm i nivelit të zbatimit dhe cilësinë e rekomandimeve të dhëna, me qëllim që realizimi i shërbimit të auditimit të shihet si vlerë e shtuar nga titullari e njësisë publike dhe të gjithë grupet e interesit.
- Bashkëpunimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të menaxhuar programe sa më cilësore të trajnimit të vijueshëm profesional duke përfshirë në program tema që zhvillojnë kapacitetet profesionale të audituesve të brendshëm
- Miratimin e regjistrit të riskut të konsoliduar nga Nëpunësi Autorizues dhe të hartimin e instrumentave për menaxhimin e riskut sipas përcaktimeve rregullative të fushës, hartimi i urdhërit të Grupit të Menaxhimit të Riskut „strategjia e menaxhimit të riskut (plani i menaxhimit të riskut), dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve , për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre. Gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik të trajtohen problematika që lidhen me MFK-në duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi
- Përditësimin e rregulloreve të brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të njësisë publike dhe me bazën rregullatore të kontrollit të brendshëm.
- Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, ndërtimin e hartave dhe manualeve të proceseve të punës dhe konsolidimin në një dokument të vetëm.
- Hartimin e planit vjetor të punës të konsoliduar për të gjithë institucionin duke përcaktuar qartë linjën e raportimit.

VII. SPONSORIZIMET PER VITIN 2023

Për vitin 2023 Bashkia Shkodër ka marre sponsorizime ne natyre në shumën **21,956,581 leke** si më poshtë vijon:

Shoqata VURR & VLAM ALBANIE Belgjike (Makine zjarrfikese dhe Paisje per sherbimin zjarrfikes)	262,210
Fondi Shqiptar I Zhvillimit (Dhurime kazane pastrimi)	8,136,000
Fondi Shqiptar I Zhvillimit (Dhurime çimento)	216,648
World Vision (Dhurime paisje kompjuterike)	6
World Vision (Dhurime mjete didaktike)	124,237
Shoqata Mision pa kufi (Dhurime paketa ushqimore)	200
Fondi Shqiptar I Zhvillimit (Kazane , peme dekorative)	9,109,800
Fondi Shqiptar I Zhvillimit(Stola)	4,107,480
Shuma	21,956,581

Donacione /Sponsorizime totale për vitin 2023, në shumën prej 3,863,135 lekë, si më poshtë, të detajuara:

DONACIONE/SPONSORIZIME	SHUMA
PROJEKTI FARO- TRASHEGIMI TE NDRYSHME NE QYTEZAT EUROPIANE	603,654
PROJEKTI PEOPLOE -ATRIUM	475,412
UNDP	1,636,134
Projekti Hold On	1,147,935
TOTALI	3,863,135

VIII. TREGUESIT FINANCIARË QË PUBLIKOHEN.

	Treguesit financiarë	2023
1	Shpenzimet e përgjithshme / Te ardhurat e përgjithshme	71%
2	Taksat dhe tarifat lokale / Të ardhurat e përgjithshme	70%
3	Te ardhurat nga burimet e veta/te ardhurat e përgjithshme	91%
4	Të ardhurave faktike të mbledhura, kundrejt planit të periudhës dhe planit vjetor të të ardhurave	98%
4/1	Të ardhurave faktike të mbledhura, nga dy kategoritë kryesore të taksapaguesve, personave fizikë e juridikë (familjarë dhe subjekteve juridike)/ kundrejt planit vjetor të të ardhurave	73%
5	Shpenzimet kapitale/Shpenzimet e përgjithshme	27%
6	Shpenzimet e personelit /Shpenzimet e përgjithshme	34%
7	Shpenzimet korente /Totalit te shpenzimeve	73%
8	Huamarrjes afatgjatë ndaj totalit te te ardhurave	Nuk ka
9	Huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	Nuk ka
10	Detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj të tretëve ndaj të ardhurave të përgjithshme;	0,03 %
11	Shpenzimeve për partneritetet publike private ndaj shpenzimeve të përgjithshme;	Nuk ka
12	Shpenzimeve për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.	31.9%

Nënshkruar nga:
Benet BECI

Nëpunësi Autorizues
KRYETAR I BASHKISË SHKODËR

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Onid BELLERI

Bashkia Qendrore N.Z Blerta Mjeda
Institucioni Dega Ekonomike e Kulturës N.Z Ingrid Gushta
Institucioni Drejtoria e Kopshte Çerdheve N.Z Gilbert Marku
Institucioni Teatri "Migjeni" N.Z Gerti Gjyli
Institucioni Drejtoria Ekonomike e Arsimit N.Z Samira Osmanagiq
Institucioni Drejtoria MZSH N.Z Frano Pjetri
Institucioni Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore e Pyjore N.Z Agim Bushaj
Institucioni Shtëpia e Foshnjes 0-5 vjeç N.Z Silva Çoba
Institucioni Shtëpia e Fëmijës Shkollor N.Z Fausta Deda
Institucioni Qendra e Zhvillimit N.Z Rubin Jovani